

VENDIM
Nr.1194, datë 3.12.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
TRANSBALLKANIKE, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9839, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës transballkaniqe, Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1235 (një mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) m², tokë truall, me vlerë 29 366 168.3 (njëzet e nëntë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tre) lekë, për objekte, me sipërfaqe të përgjithshme 691.9 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një presje nëntë) m², me vlerë 42 435 706.8 (dyzet e dy milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtë pikë tetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 71 801 875.1 (shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 71 801 875.1 (shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë një) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 7.12.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2010.

7. Për pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “Urdhër kufizimi” dhe “Kufizim i plotë i dokumentacionit ligjor”, të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, dhe konfirmimi, që do të merret nga kjo zyrë.

8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Urdhër kufizimi” dhe “Kufizim i plotë i dokumentacionit ligjor”, në bazë të pikave 6 e 7 të këtij vendimi, dhe të dokumentacionit të pronësisë, ndërsa për pronarët e konfirmuar të kryejë likuidimin e tyre, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi Vlore

Bashkia Vlore

LISTA E PRONAREVE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME PRONE PRIVATE QE PREKEN SI REZULTAT I RRUGES "TRANSBALLKANIKE"

Lloji i Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Pas.	ZK	TRUALL			Objekte			Vlera totale ne leke	Shenime
						Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefta ne leke	Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefta ne leke		
1	Nuri		Dino	20/93	8603				20	31137	622740	622740	Konfirmuar nga ZRPP
2	Stavri		Karajani	18/11	8603	88	24860	2187680				2187680	Konfirmuar nga ZRPP
3	Resul Rakip Sokol	Hamit Hamit Hamit	Agaci Agaci Agaci	18/10	8603	101	29842	3014042				3014042	Konfirmuar nga ZRPP
4	Tokli		Qarri	18/12	8603	68	29842	2029256				2029256	Hipotekuar AGRI sh.p.k
5	Bashkepronaret		Konstandini	33/128	8604	381	22748	8666988	144	67100	9662400	18329388	Konfirmuar nga ZRPP
6	Elpiniqi Irena Klanda		Konstandini Skendaj Lena	33/128 - ND1	8604				66	67100	4428600	4428600	Konfirmuar nga ZRPP
7	Bashkepronaret		Kona + Janina	35/68	8604	389	22748	8848972				8848972	Konfirmuar nga ZRPP
8	Argjine		Ismahili	4/176	8604	20	14392	287840				287840	saktesim VKKKP
9	Azbi		Ismaili	4/242	8604	15	14392	215880				215880	Konfirmuar nga ZRPP "Kufizim te plot te dok ligjor"
10	Azbi	Zequir	Ismaili	4/3+1- ND8	8604				104	67100	6978400	6978400	Konfirmuar nga ZRPP
11	Flora Hito		Cekodhima Hitaj	5/46-ND1	8604	3	14392	43176	23	67100	1543300	1586476	Konfirmuar nga ZRPP
12	Xhevrie		Zeraj	5/34-ND	8604				45	67100	3019500	3019500	Konfirmuar nga ZRPP
13	Spiro		Karpuzi	18/140	8604				79	67100	5300900	5300900	Konfirmuar nga ZRPP
14	Gezim		Shaqiri	18/139	8604				79	67100	5300900	5300900	Konfirmuar nga ZRPP
15	Fanie	Rrapi	Bezhani	5/106; 5/29-ND	8604	20	14392	287840	10	67100	671000	958840	Konfirmuar nga ZRPP
16	Bashkepronaret		Gjirkokaj	33/166	8604	29	22748	659692	44	67100	2952400	3612092	Konfirmuar nga ZRPP
17	Koco	Kozi	Xhaho	49/227	8605	51	25889	1320339				1320339	Konfirmuar nga ZRPP "Urdher kufizimi"
18	Guri Yllka		Gaçe Gaçe	33/321	8605	69.7	25889	1804463.3	37.48	25110	941122.8	2745586.1	Konfirmuar nga ZRPP "Urdher kufizimi"
19	Asqeri	Tare	Resuli	29/31-ND	8605				40.4	25110	1014444	1014444	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				1234.7		29366168.3	691.9		42435706.8	71801875.1	

